

**VENDIM**  
**Nr. 1112, datë 16.12.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKINË SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 240 505 492 (dyqind e dyzet milionë e pesëqind e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në Bashkinë Shijak.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020 dhe i transferohet Bashkisë Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**